



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
***Kuvendi - Skupština - Assembly***

---

**Legjislatura V**

Sesioni pranveror

Komisioni për Legjislacion, Mandate,  
Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen  
e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Mbledhja nr. 67

Prishtinë, më 7.6.2016, në orën 9:30

Ndërtesa e Kuvendit, salla C 203

**PROCESVERBAL**

I mbledhjes së Komisionit

**Në mbledhje morën pjesë:** Albulena Haxhiu, Selvie Halimi, Agim Aliu, Nezir Çoçaj, Armend Zemaj, Agim Ademaj, Doruntinë Maloku, Danush Ademi dhe Milena Miliçeviq.

**Munguan:** Donika Kadaj-Bujupi dhe Valdete Bajrami.

**Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë:** Behxhet Shala - KMDLNj, Artan Canhasi-KDI, Arton Demhasaj-ÇOHU, Blerta Bejtullahu-EUSR/EU Office, Dibran Istrefi-Klan Kosova dhe Ardianë Thaçi-KTV.

**Nga Stafi i Komisionit:** Visar Krasniqi dhe Fatbardha Boletini.

**Mbledhjen e kryesoi,** Albulena Haxhiu, kryetare e Komisionit.

**Rendi i ditës:**

**Inervistimi i kandidatëve për pozitën e drejtorit të Agjencisë Kundër Korrupsionit**

*Kryetarja Konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së rendit të ditës.*

**Kryetarja**, i njoftoi të pranishmit për përgatitjet e bëra para fillimit të intervistimit e që kanë dal si konkluzione edhe nga mbledhjet e kaluara.

Para fillimit të intervistimit, kryetarja propozoi që në pajtim me vendimet e kaluara të Komisionit, të caktohen edhe disa rregulla shtesë. Fillimisht rikujtoi siç edhe është vendos, që secili kandidat do të ketë 15 minuta në dispozicion për përgjigje. Do të jenë tri pyetje; një do të parashtrohet nga kryetarja Komisionit, një nga nënkryetarja Selvije Halimi dhe një pyetje nga deputeti Armend Zemaj. Pyetjet do të jenë të njëjta për secilin kandidat dhe Komisioni do të zhvillojë intervistimin pa ndërprerje deri në intervistimin e kandidatit të fundit.

Komisioni vendosi që mediat të marrin pamjet nga takimi i Komisionit, por jo edhe të qëndrojnë gjatë gjithë kohës. Kurse për prezencën e shoqërisë civile, u vendos që ata që hynë në sallë për monitorim ku duhet të qëndrojnë deri në fund të intervistimit.

- Pyetja nga kryetarja Komisionit, Albulena Haxhiu ishte: A mendoni që është bërë mjaftë në hetimin dhe luftimin e korrupsionit dhe a mendoni që pakaja kundër korrupsionit duhet të ndryshohet ?
- Pyetja nga nënkryetarja Selvije Halimi ishte: Në rast se do të zgjidheni drejtor i Agjencisë, cili do të ishte objektivi juaj në fushën e konfliktit të interesit ?
- Pyetja nga deputeti Armend Zemaj ishte: Ligji për Agjencinë Kundër Korrupsionit parasheh strategjinë dhe planin e veprimit. Në rast se zgjidheni drejtor çka do të ndryshonit në këtë dokument ?

Para se të ftohet kandidati i parë, nga kryetarja e Komisionit u bë me dije se kandidati parë Musa Dragusha, ka ofruar dorëheqje me shkrim nga kandidatura.

*Komisioni pas shqyrtimit të të gjitha çështjeve që kishin të bënin me përgatitjet e intervistimit të kandidatëve, vlerësoi se janë bërë të gjitha përgatitjet për t'ia filluar punës.*

Intervistimi i kandidatëve filloi në orën 10:15. Së pari u intervistua kandidati Gani Haxholli dhe pas tij u intervistuan: Esad Ejupi 10:30, Sadri Abazi 10:40, Gëzim Kolgeci 10:55, Riza Krasniqi 11:10, Anila Berisha 11:18, Mehdi Pllashniku 11:50, Agron Behrami 12:00, Burim Sadiku 12:10, Avni Zogjani 12:25, Albert Mirdita 12:36, Suzan Novobërdaliu 12:50, Afrim Atashi 13:15, Blerim Kelmendi 13:55, Bashkim Salihu 14:30, Sami Shatri 14:44, Labinot Lekaj 14:55, Shaip Havolli 15:30, Arben Muhameti 15:40, Flamur Keqa 15:50, Lulzim Xhymshiti 16:12, Fehmi Reka 16:20 dhe Shemsi Jashari 16:30.

*Derisa po zhvillohej intervistimi, kandidatëve, Komisioni u njoftua me shkrim për dorëheqjen e Ilaz Duli.*

Pas përfundimit të intervistimit, u konstatua se nga 29 kandidatë sa kishin aplikuar për këtë pozitë, 23 prej tyre ju nënshtruan intervistimit, 2 kandidatë kishin ofruar dorëheqjen me shkrim nga kandidatura ( Musa Dragusha dhe Ilaz Duli ) dhe 4 kandidatë nuk morën pjesë në intervistim ( Sebahate Majanci, Kadri Kadrijaj, Gafur Podvorica dhe Arton Çitaku ).

Komisioni, pas përfundimit të intervistimit të 23 kandidatëve, duke u bazuar në vlerësimin e anëtarëve të Komisionit, pra në poentimin e secilit kandidat, veçoi se Burim Sadiku u vlerësua me 85 pikë dhe Shaip Havolli me 78.5 pikë.

*Kryetarja konstatoi se në pajtim me nenin 8 të Ligjit nr. 03/L-159, për Agjencinë Kundër Korrupsionit, dhe në pajtim me nenin 67 të Rregullores së Kuvendit, vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:*

### **R e k o m a n d i m**

- I. I rekomandohen Kuvendit për votim kandidatët për pozitën e drejtorit të Agjencisë Kundër Korrupsionit, si në vijim:
  1. Burim Sadiku – 85 pikë, dhe
  2. Shaip Havolli – 78.5 pikë.
- II. Kuvendi, prej 2 (dy) kandidatëve të propozuar për drejtor të Agjencisë, do të zgjedhë njërin nga kandidatët.
- III. Votimi i kandidatëve për drejtor të Agjencisë, bëhet me votim të fshehtë.
- IV. Mandati i drejtorit të Agjencisë është 5 (pesë) vjet dhe fillon nga data 24.9.2016.

Mbledhja përfundoi në orën 17:00.

E përgatiti:

Stafi Mbështetës i Komisionit

Kryetarja e Komisionit

---

**Albulena Haxhiu**